



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 903 Prot.

Tiranë, më 13.03.2023

Lënda: Kërkesë për zhvillimin e Seancës Plenare, 13.3.2023

Baza Ligjore: Nenet 7, 12 dhe 40/1 të Rregullores së Kuvendit

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit

Këtu

Znj. Nikolla,

Neni 40/1 i Rregullores së Kuvendit përcakton rregullat dhe procedurat për Programin e Veprimtarisë Parlamentare të Kuvendit si më poshtë vijon.

1. *Kuvendi zhvillon veprimtarinë parlamentare sipas rregullave të mëposhtme:*
 - a) *Ditën e hënë, si rregull, zhvillon veprimtari të grupeve parlamentare për t'u përgatitur për veprimtarinë gjatë javës në komisionet e përhershme parlamentare ose organet e tjera të Kuvendit dhe seancën plenare, sipas përcaktimit të bërë në kalendarin trejavor të punimeve të Kuvendit.*
 - b) *Ditën e martë dhe të mërkurë, si rregull, zhvillon veprimtari në komisionet e përhershme ose në organet e tjera të Kuvendit.*
 - c) *Ditën e enjte, si rregull, zhvillon punime në seancë plenare.*
 - d) *Ditën e premte, si rregull, zhvillohet veprimtari e deputetëve dhe e grupeve parlamentare për njohjen e zgjedhësve me punimet e Kuvendit dhe për trajtimin e problemeve që kanë zgjedhësit në qarqe dhe zonat zgjedhore.*
2. *Programimi i veprimtarisë parlamentare, sipas pikës 1, shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, zbatohet për tre javë të njëpasnjëshme kalendarike.*
3. **Java e katërt kalendarike është në dispozicion të deputetëve dhe grupeve parlamentare për veprimtari të përcaktuara në pikën 1, shkronja "ç", të këtij neni.**

4. Kuvendi zhvillon punime në seancë plenare për diskutimin e çështjeve të evidentuara nga zgjedhësit pasditen e ditës së hënë, që pason javën me veprimtari njohëse me zgjedhësit, sipas pikës 3 të këtij neni. Seanca plenare zhvillohet për jo më shumë se katër orë, ku koha e diskutimevendahet në mënyrë të barabartë mes shumicës dhe pakicës, duke marrë parasysh edhe deputetin e pavarur ose deputetin jashtë grupeve parlamentare. Koha e diskutimit brenda shumicës ose pakicës ndahet për sa është e mundur në proporcion me madhësinë e grupeve dhe numrin e deputetëve të pavarur ose deputetëve jashtë grupeve parlamentare.
5. Rregullat e pikave 1-3 të këtij neni nuk zbatohen kur Kuvendi ka një çështje urgjente apo kërkesë për një projektakt me procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Pika 3 e këtij Neni ka përcaktuar qartë që javën e katërt, ose sic quhet ndryshe “green eëek”, deputetët duhet t’ja përkushtojnë zonave të tyre elektorale e të fokusohen në çështje të zgjedhësve. Rregullorja përcakton në mënyrë taksative që për të gjitha problematikat e kësaj jave, deputetët diskutojnë në seancën e ditës së hënë në javën pasardhëse.

Ndër seancat që zhvillohen në një muaj, kjo është seanca më e rëndësishme, pasi të gjithë deputetët duhet të diskutojnë për çështje të votuesve të tyre. Për këtë arsye, Rregullorja e Kuvendit nuk e lë zhvillimin e kësaj séance në dëshirën e Kryetares së Kuvendit apo në një vendimmarrje nga ana e saj. Të vetmet raste kur ky rregull nuk ndiqet, të parashikuara në pikën 5 të nenit 40/1, janë “për çështje urgjente apo kërkesë për një projektakt me procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin dhe miratimin e tij”.

Pika 5 e Nenit 40/1, në asnjë rast nuk përcakton ndryshimin e kalendarit, procedurave apo rregullave, aq më pak për anulimin e një séance plenare për “arësye jashtëparlamentare”. Për një deputet të Kuvendit të Shqipërisë, nuk ka asnjë aktivitet parlamentar më të rëndësishëm se aktiviteti parlamentar.

Ditën e premte, deputetët janë njoftuar përmes një emaili të stafit të Kuvendit që “seanca plenare e datës 13 mars 2023, ashtu sic është parashikuar në Kalendarin e Punimeve të Kuvendit, nuk do të zhvillohet pasi deputetët do të jenë të angazhuar

në veprimtari jashtë parlamentare”. Në email nuk ka asnjë referencë ligjore, të një Vendimi apo Urdhëri.

Neni 12, pika 1 përcakton”

“Konferenca e Kryetarëve diskuton dhe vendos për programin e punës, kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe të komisioneve të tij, si dhe për çështje të zhvillimit të punimeve të Kuvendit në seancë plenare.”

Ndërsa pika 4:

“Në Konferencën e Kryetarëve shqyrtohet programi i punës dhe kalendari i punimeve të Kuvendit mbi bazën e propozimit të Kryetarit të Kuvendit. Si rregull, programi i punës dhe kalendari i punimeve miratohen me mirëkuptim nga Konferenca e Kryetarëve dhe kur kjo nuk realizohet, Kryetari ia paraqet ato Kuvendit në seancë plenare, në përputhje me nenet 26 dhe 27 të kësaj Rregulloreje.”

Seanca e datës 13 mars, është miratuar në (sic referohet edhe në emailin e stafit të Kuvendit), në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe i është njoftuar Seancës Plenare.

Vetëm dy janë organet që mund të bëjnë ndryshim të Kalendarit të Punës së Kuvendit: Konferenca e Kryetarëve ose Seanca Plenare. **Rregullorja e Kuvendit nuk e lë në dëshirën apo në vendimmarrjen e Kryetares së Kuvendit.** Meqenëse asnjëri prej tyre nuk ka vendosur ndryshe, anulimi i seancës së datës 13 mars 2023, është në shkelje të rëndë të Rregullores së Kuvendit.

Neni 7 i Rregullores së Kuvendit përcakton qartë detyrat e përgjegjësitë e Kryetarit të Kuvendit. Pika 1 e këtij Neni përcakton:

“Kryetari i Kuvendit ... kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe strukturave të tij.”

Seanca plenre është aktiviteti më I rëndësishëm parlamentar. Anulimi i seancës së datës 13 mars 2023, është në shkelje të rëndë të Rregullores së Kuvendit dhe përgjegjësia për këtë shkelje bie direkt mbi Kryetaren e kuvendit znj. Lindita Nikolla e cila me vendimin për anulimin e seancës ka shkelur të drejtën e deputetëve për të përfaqësuar në Kuvend problematikat e zonave të tyre elektorale.

Ne e konsiderojmë anulimin e seancës plenare të datës 13 mars 2023, një akt të rëndë kundër parlamentarizmit, një akt atikushtetues.

Kërkojmë nga Kryetarja e Kuvendit:

- Të thërrase Seancën Plenare të datës 13 mars 2023, sic është parashikuar në kalendarin tre javor të Kuvendit në zbatim të neneve 7, 10 dhe 40/1 të Rregullores së Kuvendit;

DEPUTETËT:

Derol Bylykbeoshi
Albana Vokshi
Elda Hoti
Luon Boer
Lutf Selaj
Fetret Vanli
Hemur Nohu
Sule Nuh
[Signatures]